



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr. 7108 /2018

Data: 22.07.2018

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e shtatë - VII- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 16.07.2018 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Medina Imishti (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Menduh Vlasi (Drejtor për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Bajrush Laç (Shef i Zyrës Ligjore), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim), Irfan Suma (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit). Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i kuvendit të komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Miratimi i propozimit për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2019.
3. Informatë mbi raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2017.
4. Informatë për planin e veprimit të komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2017.
5. Informatë për procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
6. Njoftim për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2018.
7. Miratimi i plotësim ndryshimit të rregullores për ndarjen e subvencioneve.
8. Miratimi i propozim vendimit për fillimin e hartimit të planit zhvillimorë komunal.
9. Miratimi i propozim vendimit për fillimin e hartimit të hartës zonale të komunës.
10. Pyetje dhe përgjigje.

Kryesuesi thekson:- përveç këtyre pikave të rendit të punës kemi edhe një pikë shtesë, kërkesën e z.Minir Curi për ndërrim destinim të tokës. Lidhur me rendin e punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- kjo kërkesë ka të bëjë me ndërrim destinimin e tokës sepse pala kur ka aplikuar për leje ndërtimore ju është kërkuar sepse përcaktohet në ligj që duhet të bëhet ndërrim destinimi. Komisioni ka dal në vendin e ngjarjes dhe ka hartuar raport për këtë çështje. Për mos me u vonuar procedura për leje të ndërtimit është përcjellë drejtë për drejtë në kuvend.

Florim Shkreta thekson:- kjo çështje nuk është problematike por drejtoria duhet të jetë më e sinqertë në këtë drejtim sepse shumë shpesh ka sjellë dokumente dhe po na befason. Kjo kërkesë nuk është problem por mund të sjellë edhe ndonjë dokument tjetër me shumë rëndësi dhe ne mund të ngutemi. Unë nuk jam kundër kësaj por pak si shpesh po ndodhin këto gjëra.

Kryesuesi thekson:- prona është private të drejtë me ndërtuar ka dhe këtu vetëm ndërrim destinimi bëhet dhe asgjë tjetër. A ka edhe ndonjë diskutim sa i përket materialit shtesë, nëse nuk ka e hedh në votim kërkesën e z.Ministr Curri për ndërrim destinim të tokës, rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës, rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 15 anëtarë të kuvendit të komunës).

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:-

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Miratimi i propozimit për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2019.
3. Informatë mbi raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2017.
4. Informatë për planin e veprimit të komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2017.
5. Informatë për procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
6. Njoftim për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2018.
7. Miratimi i plotësimit ndryshimit të rregullores për ndarjen e subvencioneve.
8. Miratimi i propozimit vendim për fillimin e hartimit të planit zhvillimorë komunal.
9. Miratimi i propozimit vendim për fillimin e hartimit të hartës zonale të komunës.
10. Miratimi i kërkesës së z.Ministr Curri për ndërrim destinim të tokës.
11. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mefail Suma thekson:- faqe tre të diskutimi imë fjala epikë të zëvendësohet me fjalën ekip. Faqe pesë të diskutimi imë fjala termi të zëvendësohet me fjalën tema.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë vërejtje, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte 14 për 1 abstenim (prezent ishin 15 anëtarë të kuvendit të komunës).

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Miratimi i propozimit për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2019.

Kryesuesi thekson:- gjatë diskutimeve në KPF u dakorduar që përbërja e këtij komisioni të jetë nga anëtarët e komitetit për politikë e financa sepse në këtë mënyrë kemi vepruar edhe në vitin e kaluar. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Akif Shkreta thekson:- në komitet për politikë e financa jemi pesë anëtarë propozoj që të jetë edhe një përfaqësues nga subjekti politik “Nisma” dhe një anëtarë nga komiteti për komunitete.

Memet Ballazhi thekson:- në KPF diskutuam që të ketë përfaqësim politik që do të thotë që të përfshihet edhe subjekti politik Nisma por edhe drejtori për buxhet dhe financa duhet të jetë anëtarë sepse i bënë planifikimet financiare.

Mefail Suma thekson:- pjesërishtë e përkrah propozimin e z.Akif Shkreta , por propozoj që njëra parti që i ka katër këshilltarë t'i ipet e drejta që ta shtonë edhe një anëtarë të komisionit.

Mallzum Qajani thekson:- sa i përket ekzekutivi është pjesë e gjitha aktiviteteve në kuvend dhe në ekzekutiv, kështu që na si ekzekutiv s'jemi pjesë e komisionit por jemi pjesë e planifikimeve dhe nuk ka nevojë me kanë pjesë në atë komision.

Memet Ballazhi thekson:-ju diskutoni në bordin e drejtorëve por ne si komision nuk kemi qasje dhe për atë po them që më mirë do të ishte që drejtori i financave me qenë pjesë e komisionit.

Akif Shkreta thekson:- unë mendoj që të jetë prej shtatë anëtarëve dhe të jetë një përfaqësim politik.

Isni Bushi thekson:- unë e përkrah propozimin e z. Mefail Suma.

Kryesuesi thekson:- propozimin e z.Mehmet Ballazhi që komisioni të përbëhet prej pesë anëtarëve dhe t'i shtohet një përfaqësues i subjektit politik Nisma dhe drejtori për buxhet dhe financa, e hedh në votim ; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 15 anëtarë të kuvendit të komunës).

U MIRATUA PROPOZIMI PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2019

3. Informatë mbi raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2017.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- zyra kombëtare e auditimit ka dhënë opinionin e auditimit që është i pa modifikuar me theksim të çështjes. Në bazë të këtij raporti del që komuna e Hanit të Elezit i ka tetë rekomandime. Në krahasim me vitin 2016 është se komuna e Hanit të Elezit i ka pas 15 rekomandime kurse për vitin 2017 tetë rekomandime. Rekomandimet janë të cekura në raport dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mefail Suma thekson:- rekomandimet të cilat janë dhënë nga auditori i mbaj mend që nga viti 2009 deri në vitin 2013 janë dërguar këto rekomandime dhe po më duket që janë disa të ngjashme prej atyre viteve. Pse komuna jonë nuk ka auditorë të brendshëm? A është regjistri pasurisë së komunës? A është regjistruar pasuria e patundshme e komunës?

Shabi Rexhallari thekson:- komuna e ka një regjistër sa i përket pasurisë por nuk është i kompletuar për shkak se disa financime që i kemi nga Ministrinë dhe nuk na është ofruar materiale për shkak se kemi kërkuar por ende nuk i kemi marr. Kërkesë kemi parashtruar në Ministri për lejimin e auditorit por ende nuk na e kanë lejuar. Pronat të cilat janë në kadasër në emër të komunës janë të regjistruara.

Florim Shkreta thekson:-kur është bërë kërkesë për themelimin e auditimit të brendshëm sepse punësohen personat në komunë dhe është shumë e rëndësishme me u themeluar auditori i brendshëm, kurse disa punëtorë që pranohen si tepriçë teknologjike mirë do të ishte që me prit ato ren.

Shabi Rexhallari thekson:- kërkesë për çdo vit parashtrëjmë dhe nuk e bëjmë vetëm për themelimin e auditimit por parashtrëjmë edhe për staf tjetër por nuk kemi marr përgjigje.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparës sipas rendit të punës.

4. Informatë për planin e veprimit të komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2017.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- për secilin rekomandim kemi përcaktuar kohën se kur do të arrihen. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Memet Ballazhi thekson:- a keni ndonjë datë të caktuar të plotësimit të rekomandimeve dhe cili është afati i mundshëm i plotësimit të këtyre rekomandimeve.

Shabi Rexhallari thekson:- në material i keni të shënuara me muaj dhe me vite se kur planifikohen të përmbushen rekomandimet.

Nuriman Kuka thekson:- gradualisht duhet të xhindet një formë për me bërë inkasmin e borxheve për shkak se në të ardhmen na bien barrë si komunë.

Mefail Suma thekson:- cila kompani i ka më së shumti borxh komunës.

Teuta Shkreta thekson:- shtimi i stafit në komunë a bëhet përmes drejtorive përkatëse në komunë apo si është forma.

Florim Shkreta thekson:- një pjesë e qytetarëve i kanë borxh komunës dhe nuk kanë mundësi për me i paguar për shkak se kanë obligime familjare të cilat janë të domosdoshme. Taksa në shumë 10 € për regjistrimin e automjeteve propozoj që të hiqet.

Nora Xhoni thekson:- nëse nuk i plotësojmë rekoandimet e dhëna si komunë a kemi ndëshkim prej auditimit.

Shabi Rexhallari thekson:- obligime financiare më së shumti i ka komunës terminali doganorë me të cilin jemi në procedurë gjygsore. Për qytetarët të cilët nuk i kanë kryen obligimet e tatimit në pronë kemi filluar duke i njoftuar me vërejtje dhe kanë filluar me i kryer obligimet ndaj komunës. Për shtimin e stafit drejtorit parashtrorj një kërkesa dhe kryetari i komunës përgatit kërkesën dhe e dërgon në Ministri të linjës. Sa i përket taksës që propozua me u hekë kjo është e përcaktuar me ligjin mbi financat e pushtetit lokal. Dënim nuk ka nga auditori por sa ma pak rekomandime me pas është më mirë për komunën.

Memet Ballazhi thekson:- këtë taksë në disa komuna e kanë hekë krejt sepse më doket se është një lloj plaçke por nëse e përcakton ligji duhet ta respektojmë ligjin.

Mefail Suma thekson:- sa i përket taksës së terminalit jemi pas dakorduar që me i ndihmuar komunës dhe kemi përcaktuar taksën në shumë 20000 € dhe po që se është e njëjta shumë mendoj që është pak e tepërt për shkak se në atë kohë vullnetarisht është bërë që me i ndihmuar komunës dhe tash është mirë që t'i përgjysmohet kjo shumë.

Florim Shkreta thekson:- për çfarë arsye ka shkuar lënda e terminalit përmes gjykatës. A ka komision komuna që i përcakton kategoritë për me ua përcaktuar taksën e tatimit dhe në far forme llogaritet, a merret parasysh kompania se a ka të hyra apo nuk ka apo ndoshta komisioni vendos që të jetë kjo shumë.

Mallzum Qajani thekson:- taksat dhe tarifat ekzistojnë prej se ekziston ligji për akumulimin e të hyrave vetanake në nivel të komunës. Shuma borxheve që janë daton që nga viti 2002 kur komuna e Kaçanikut ka filluar me mbledh taksa dhe ato borxhe dhe taksa që kanë rrjedhë kur është bërë komunë Hani i Elezit ju kanë

ndarë Hanit të Elezit dhe kryesisht borxhi më i madh është tatimi në pronë. Komuna për çdo vit miraton rregulloren për taksa dhe tarifa dhe as kryetari i komunës nuk mundet me i ndryshuar por jeni ju ata të cilët i rregulloni sepse kuvendi i komunës për çdo vit e rishqyrton rregulloren për taksa dhe tarifa.

Shabi Rexhallari thekson:- për pjesën që është në gjykatë për tri vite 2010-2012 taksa ka qenë 20 000 €. Taksa në shumë prej 20 000 € që ka qenë për terminalin doganorë tash është në shumë 8000 €. Taksën për mjetet motorike neni 12 i ligjit për financat e pushteti lokal e përcakton.

Kryesuesi thekson:- taksat i ka miratuar për çdo vit kuvendi i komunës kurse propozimet i bënë ekzekutivi i komunës.

Akif Shkreta thekson:- gjatë shqyrtimit të rregullores për taksa dhe tarifa kemi pas kërkesa nga bizneset që me zbrit taksën dhe kuvendi i ka miratuar, kurse për rastin e mos pagesës është çështja e gjykatës se si do të vendosë.

Teuta Shkreta thekson:- sa i përket shtimit të stafit shëndetësia është keq dhe duhet të kontribuojmë të gjithë në mënyrë që të rritet stafi në drejtorin e shëndetësisë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparës sipas rendit të punës.

5. Informatë për procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- ligjit të vjetër për legalizim i ka skaduar afati dhe tani për tani Kosova nuk ka ligj për trajtimin e objekteve pa leje. Qeveria e ka proceduar për kuvend por ende nuk është miratuar.

Florim Shkreta thekson:- kërkoj informacion me shkrim për mënyrën se si ka shkuar procesi i legalizimit. Sa kanë aplikuar për legalizim. Sa janë refuzuar dhe arsyeja e refuzimit. Sa janë pajisur me leje të ndërtimit në vitin 2017. Në momentin që është diskutuar çështja e legalizimit është shtuar edhe më shumë numri i ndërtimeve pa leje.

Nexhmedin Daci thekson:- ky ligj faktikisht ka dështuar që nga fillimi. Komuna e ka themeluar komisionin për regjistrimin e ndërtimeve pa leje dhe në bazë të komisionit komunal janë evidentuar 2002 ndërtime. Ligji ka dështuar për shkak të tarifave të larta dhe procedurave të komplikuar. Me sa jam i njoftuar në komunën tonë kanë aplikuar 29 persona.

Zirafete Axhami thekson:- sa është numri i ndërtimeve pa lejen në komunën tonë duke përfshirë edhe fshatrat.

Nexhmedin Daci thekson:- komisionin në vitin 2014-2015 ka evidentuar 2002 ndërtime pa leje dhe në kuadër të këtyre ndërtimeve çdo objekt ndërtimorë është përfshirë në atë listë. Pas kësaj periudhe ndoshta ka pas ndërtim pa leje përsëri por në momentin që do të miratohet ligji i ri komuna do ta rifreskon listën e ndërtimeve pa leje.

Sabedin Hasallari thekson:- a ka prona të uzurpuara në komunën tonë. Komuna a ka ndonjë rast që ka uzurpuar.

Nexhmedin Daci thekson:- që nga pas lufta ka uzurpime që qytetarët kanë hyjë në pronë publike por të gjitha kanë me u trajtuar me ligj të ri. Uzurpime nuk e di që komuna ka por në momentin që do të behët ligji i ri do të trajtohen.

Mefail Suma thekson:- çka i pengon komunës nëse në fshatin Dimcë bëhet ndonjë ndërtim pa leje.

Mallzum Qajani thekson:- me që komuna e Hanit të Elezit nuk ka bërë ndonjë planifikim hapësinorë sipas të cilit duhet të zhvillohet komuna e Hanit të Elezit. Në qoftë se ju kujtohet ne kemi bërë një plan zhvillimorë ne vitin 2012 dhe në kuadër të këtij plani ka qenë plani urbanë dhe plani rregullues që do të thotë se një pjesë e Hanit të Elezit ka hyjë në zhvillimet e më tutjeshme dhe të gjitha shtëpitë të cilat janë nëpër fshatra nuk kanë leje për arsye se nuk është kërkuar

Nexhmedin Daci thekson:- ligji nuk bënë dallime pavarësisht se a ndërtohet shtëpia në fshat apo në qytet, kurse tarifat mund të jenë të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparës sipas rendit të punës.

6. Njoftim për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2018.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mallzum Qajani thekson:- këshilli komunal për siguri në bashkësi është organ i kuvendit dhe për çdo të premtë të fundit të muajit mbanë takime të rregullta. Në këto takime diskutohen çështje aktuale të komunës së Hanit të Elezit. Materialet i keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Memet Ballazhi thekson:- në KPF diskutum dhe kërkuam që të përcaktohet afati se çka është diskutuar dhe çka është arritur. Është potencuar që është bërë riparimi i kapakëve të pusetave dhe te rubrika e afateve është dashur me u shënuar se a është kryer apo jo. Ne të shënohen gjërat konkrete që janë diskutuar në KKSB dhe a është realizuar diçka sipas kërkesave që janë parashtruar aty.

Florim Shkreta thekson:- diskutimet të cilat janë bërë nga përfaqësuesit e KKSB-së janë të rëndësishme por a është ndërmarr ndonjë hap konkret për këto diskutime.

Sabrije Krasniç thekson:- a është diskutuar çështja e kamionëve nga kufiri deri te terminali doganorë për shkak se po ka shumë pengesa, rrezikshmëri dhe ndotje të ambientit.

Nuriman Kuka thekson:- pjesë e këtij këshilli kam qenë tri vite dhe këtu diskutohen problematikat të cilat janë me rëndësi për komunën e Hanit të Elezit.

Mallzum Qajani thekson:- edhe në KPF potencuam se në qoftë se këshilli komunal për siguri në bashkësi konstaton se një çështje është ka e rrezikon popullatën e Hanit të Elezit apo ka nevojë të trajtohet dhe varësisht nga implikimet se nëse ka impikime financiare i përcillet kuvendit dhe nëse mund të kryhet nga ekzekutivi mund të kryhet dhe nuk ka problem. Këshilli për siguri në bashkësi identifikon problemet që e preokupojnë territorin e Hanit të Elezit dhe merr obligime kryetari i komunës me u marr me atë çështje. Çështja e kamionëve është diskutuar po ende nuk është gjetur ndonjë zgjidhje teknike.

Florim Shkreta thekson:- është e vërtetë që disa pika që janë diskutuar mund të kenë implikime buxhetore por çështja e ndotjes së ambientit, zhvillimi i punimeve nga kompania “Belteleka” duhet që t’i bëhet kërkesë, mbrojtja e pyjeve nga prerësit ilegal nuk kërkon kosto buxhetore, personat të cilët vozisin me shpejtësi të lartë dhe është mirë që të ju kushtohet rëndësi këtyre çështjeve.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparës sipas rendit të punës.

7. Miratimi i plotësimit ndryshimit të rregullores për ndarjen e subvencioneve.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlasi thekson:- gjatë viteve të kaluar te ndarja e bursave kemi hasur në parregullsi dhe kemi praktikuar një rregull që i kemi ftuar studentët kur i kemi ranguar në listë dhe më kërkesën e studentëve e kemi futur në procedurë plotësim ndryshimit. Të gjitha plotësim ndryshimet që janë propozuar që të miratohen shkojnë në favor të studentëve të mirë. Gjatë debatit të mbajtur me qytetarë janë dhënë propozime të ndryshme. Propozimi i z.Amir Bushi është që të hiqet librezja e mjekut te rastet me aftësi të kufizuara sepse është vështirë me u rregulluar por të nxirret vërtetim nga mjeku. Të specifikohet se cili prind i mungon studentit. Propozimi i z.Sanet Imishti është që fëmijët e veteranëve dhe rastet sociale mos të jenë me një kategori. Propozimi i z.Sinan Curri për studentët të cilët studiojnë jashtë territorit të republikës së Kosovës tu ndahen bursat. Propozimi i z.Zyber Xhoni që të stimulohen studentët me drejtime deficitare. Propozimi i znj.Natyra Kalisi është që studenti i cili ka marr mirënjohje në dy vitet e fundit. Propozimet të cilat janë dhënë në KPF i keni. Unë mendoj se nëse i ndryshojmë pikët do të vijmë përsëri në problemet e rregullores së parë.

Kryesuesi thekson:- plotësim ndryshimi i kësaj rregullore ka kaluar në KPF, Kuvendin e komunës dhe në debat publik. Vota e ime është për propozimin që i ka dhënë ekzekutivi.

Florim Shkreta thekson:- propozimi për me i subvencionuar studentët të cilët studiojnë jashtë Kosovës duhet të jetë e sidomos për drejtimit të cilat kemi mungesë. Është mirë që kur të miratohet të kemi kujdes në mënyrë që në të ardhmen mos me pas probleme.

Mefail Suma thekson:- që nga pas lufta që janë ndarë bursat shuma ka qenë më së larti 50 € dhe pyetje kam për ekzekutivin se a i kanë të njëjtat rroga siç ishin atëherë sepse unë dua të them që të dyfishohet bursa të bëhet 100 € sepse ka kapacitet me dhënë këtë shumë komuna.

Akif Shkreta thekson:- fëmijët e familjeve të dëshmorëve bursa u ndahet pa kriter kurse kategoritë e dalura nga lufta të futen me një kod dhe t'i kenë nga 10 pikë.

Memet Ballazhi thekson:- në seancën e parë të kuvendit të komunës si grup parlamentarë i PDK-së kemi potencuar që do të jemi shumë bashkëpunues dhe transparentë në interes të qytetarëve e jo në interes të klaneve apo interesave individuale. Propozimi i pari i imi ishte që nëse e ndërrojmë fakultetin dhe nëse nuk është drejtim deficitare e humbë të drejtën e bursës. Prindërit e hendikepuar me ata të cilët nuk i kanë të dy prindërit qëllimi është më shumë logjik sepse ajo që si ka dy prindërit dhe ai që i ka dy prindërit e hendikepuar logjikisht kuptohet se nuk i ka dy prindërit dhe është një barrë edhe më e madhe. Fëmijës së martirit kam propozuar që t'i shtohen pesë pikë. E kemi diskutuar çështjen e subvencionit të studentëve jashtë shtetit dhe është mirë që të gjithë studentët të marrin bursë por pa mundësia e buxhetit e pa mundëson por nëse bëhet për jashtë shtetit duhet të bëhet në rajon për shkak se kemi studentë në Tiranë të cilët janë jashtëzakonisht të mirë dhe me drejtime deficitare. Nëse jeni konsultuar me ekspertë dhe nëse vlerësoni se propozimet të cilat i kam parashtruar e prishin renditjen siç keni menduar unë tërhiqem nga propozimet që i kam dhënë.

Menduh Vlasi thekson:- askush nuk është kundër që të financohen studentet të cilët studiojnë jashtë shtetit dhe nëse marrim një vendim të tillë çrregullohet rregullorja te poentimi. Në universitetin e Tetovës regjistrohen pa kriter studentët dhe nëse u japim bursë do të bëjmë diskriminim ndaj studentëve të cilët regjistrohen në universitetin shtetëror të Kosovës. Po që se votohet që të u epet vetëm atyre që studiojnë në universitet të Tetovës mendoj që është diskriminim për shkak se duhet të u epet edhe studentëve të cilët studiojnë në rajon. Dhënien e bursave nuk e kemi dyfishuar por e kemi shtuar numrin e studentëve nga 20 bursa në 30 bursa dhe po që se do të jenë mundësit duhet të u epen të gjithëve por nëse i kemi mundësit e vogla duhet tu epet studentëve të cilët janë më të mirë që në të ardhmen t'i kontribuojnë këtij vendi.

Mallzum Qajani thekson:- bursat jepen prej subvencioneve dhe shuma maksimale e komunës së Hanit të Elezit i lihet në kuotën 2.5% e shumës së përgjithshme. Nuk është problem që nuk kemi dëshirë me dhënë por janë shumë të limituara por sidoqoftë kuvendi merr vendim.

Akif Shkreta thekson:- për çështjen e studentëve të cilët studiojnë jashtë nuk është mirë të paragjykojmë për arsye se është çështje shtetërore sepse është akreditimi dhe në kuadër të akreditimit hynë edhe nostrifikimi i diplomave dhe kemi një numër të caktuar të cilët i kanë diplomat e nostrifikuara dhe janë nëpër pozita të larta të cilat janë me universitet të tilla pavarësisht a është mirë apo është keq kjo është një lloj paragjykimi.

Sabedin Hasallari thekson:- është mirë që drejtoria dhe kuvendi ta bënë një plan që gjatë regjistrimit të studentëve që kuadrat deficitare që janë sidomos në mjekësi me ndikuar në Ministri të arsimit që me u pranuar të paktë një dy apo tre studentë në drejtimin e mjekësisë për shkak se studentët nuk po kanë mundësi me u regjistruar. Duhet të shikohet mundësia që studentët të cilët studiojnë në Universitetin e Tetovë me ua mundësuar që me kaluar në Universitetin e Prishtinës dhe është mirë me bërë marrëveshje që me kontribuar në trevën tonë.

Nuriman Kuka thekson:- unë propozoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme në mënyrë që të analizohet mirë rregullorja.

Florim Shkreta thekson:- gjatë regjistrimit po kanë probleme studentët dhe si komunë duhet t'i kemi parasysh këto probleme, komuna duhet ta ketë parasysh këtë çështje. Unë besoj që mjekët me kënaqësi kishin punuar në Han të Elezit por komuna i ka dëbuar por i mbetet kohës.

Menduh Vlasi thekson:- pakënaqësi ka pas te studentët për shkak se dikush e ka notën mesatare shtatë dhe është fëmijë i veteranit i shtohen pesëmdhejt pikë dhe e kalon ata që është me notë mesatare tetë. Diskutohet vazhdimisht çështja e mjekësisë por a keni ndonjë statistikë se sa studentë janë në prag të diplomimit por në minimum janë tetë studentë që janë në prag të diplomimit dhe pse nuk e përmendni drejtimin ndërtimtarisë apo arkitekturën.

Akif Shkreta thekson:- shoh që ka probleme çështja e harmonizimit të propozimeve, kërkoj pesë minuta pauzë të konsultohemi në nivel të shefave të grupeve parlamentare.

Kryesuesi thekson:- pas konsultimit të cilët patën shefave të grupeve parlamentare hapi diskutimin.

Nuriman Kuka thekson:- pas konsultimeve që patëm në nivel të shefave u dakorduam që me u shtijë për mbledhjen e radhës.

Kryesuesi thekson:- propozimin e z.Nuriman Kuka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 13 për, 1 kundër 1 abstenim.

8. Miratimi i propozim vendimit për fillimin e hartimit të planit zhvillimorë komunal.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- materialet i keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mefail Suma thekson:- zona kadastrale e Neqafcit dhe Vërtomicës janë fshatra të pa banuar dhe pse nuk bëhet tjetër organizim i zonave kadastrale sepse qytetarët jetojnë në Han të Elezit dhe thirret Neqafc dhe Vërtomica.

Nexhmedin Daci thekson:-zonat kadastrale janë të trashëguara prej para luftës së dytë botërore dhe nëse është ndonjë parcelë me rëndësi të veçantë e që është me interes mund të kalon nga një zonë në zonën tjetër, kurse për me i hekë zonat nuk mundem sepse është procedurë e veçantë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë , nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 15 anëtarë të kuvendit të komunës).

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT ZHVILLIMORË

9. Miratimi i propozim vendimit për fillimin e hartimit të hartës zonale të komunës.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë , nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 15 anëtarë të kuvendit të komunës).

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË HARTËS ZONALE

10. Miratimi i kërkesës së z.Ministr Curri për ndërrim destinim të tokës.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 15 anëtarë të kuvendit të komunës).

U MIRATUA KËRKESA E MINISTRI CURRI PËR NDËRRIM DESTINIM TË TOKËS

11. Pyetje dhe përgjigje.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.


Akif Shkreta thekson:- propozoj që të formohet një komision nga kuvendi i komunës cili do të bashkëpunon me kompaninë “Sharrcem”. Në mbledhjen e kaluar është votuar propozimi imi të cilin e kam pas për ndotjen e ambientit por ne nuk mundemi me formuar atë tekst për me i identifikuar pistat e ndotjes në Han të Elezit , mirëpo propozoj që drejtoria t’i identifikon pistat e ndotjes së ambientit dhe tekstin e formon kuvendi.

Kryesuesi thekson:- sa i përket formimit të komisionit në mandatin e kaluar ishte në nivel të shefave të grupeve parlamentare dhe kryesuesi i kuvendit të komunës dhe përsëri mund ta bisedojmë në nivel të shefave të grupeve parlamentare përbërjen e komisionit. Deklarata për ndotjen e ambientit duhet të bëhet e përbashkët me ekzekutivin por ju duhet të dakordoheni me ekzekutivin. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë rendit të punës, nëse nuk ka ju faleminderit në pjesëmarrje

Mbledhja përfundoi në ora 12:45.

Procesmbajtësi

Arni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit

MSc. Qamush Brava

